




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



# PLANI I VEPRIMIT

## PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE - 2024

Dhjetor, 2023

## Përmbajtja:

Parathënie.....	5
Shkurtesat.....	6
<b>1. Qëllimi dhe objektivat .....</b>	<b>7</b>
<b>2. Administrimi i sistemit të trajnimeve: Aplikimi, aprovimi, monitorimi, mbikëqyrja dhe raportimi .....</b>	<b>9</b>
2.1. Faza e parë.....	9
2.2. Faza e dytë.....	10
2.3. Faza e tretë.....	11
<b>3. Trajnimet nga fusha penale.....</b>	<b>13</b>
3.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha penale.....	13
3.2. Llojet e trajnimeve nga fusha penale .....	13
3.3. Grupet e synuara nga fusha penale .....	14
3.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën penale.....	14
<b>4. Trajnimet nga fusha civile.....</b>	<b>17</b>
4.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha civile .....	17
4.2. Llojet e trajnimeve nga fusha civile .....	17
4.3. Grupet e synuara nga fusha civile .....	17
4.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën civile .....	17
<b>5. Trajnimet nga fusha komerciale .....</b>	<b>20</b>
5.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha komerciale.....	20
5.2. Llojet e trajnimeve nga fusha komerciale .....	20
5.3. Grupet e synuara nga fusha komerciale .....	21
5.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën komerciale.....	21
<b>6. Trajnimet nga fusha administrative.....</b>	<b>23</b>
6.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha administrative.....	23
6.2. Llojet e trajnimeve nga fusha administrative.....	23
6.3. Grupet e synuara nga fusha administrative.....	23
6.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën administrative.....	23
Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ .....	24

<b>7. Trajnimet në fushën e praktikës gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese.....</b>	<b>25</b>
7.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha kushtetuese.....	25
7.2. Llojet e trajnimeve nga fusha kushtetuese.....	25
7.3. Grupet e synuara nga fusha kushtetuese.....	25
7.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën kushtetuese.....	25
<b>8. Trajnimet nga fusha të drejtave të njeriut.....</b>	<b>27</b>
8.1. Rëndësia e trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut .....	27
8.2. Llojet e trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut .....	27
8.3. Grupet e synuara në fushën e të drejtave të njeriut .....	27
8.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën e të drejtave të njeriut .....	27
<b>9. Trajnimet në fushën e të drejtës evropiane.....</b>	<b>29</b>
9.1. Rëndësia e trajnimeve në fushën e të drejtës evropiane .....	29
9.2. Llojet e trajnimeve në fushën e të drejtës evropiane .....	29
9.3. Grupet e synuara në fushën e të drejtës evropiane .....	29
9.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën e të drejtës evropiane .....	29
<b>10. Trajnimet në fushën e kundërvajtjeve .....</b>	<b>31</b>
10.1. Rëndësia e trajnimeve në fushën e kundërvajtjeve .....	31
10.2. Llojet e trajnimeve në fushën e kundërvajtjeve .....	31
10.3. Grupet e synuara në fushën e kundërvajtjeve .....	31
10.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën e kundërvajtjeve .....	31
<b>11. Trajnimet në fushën e ndërmjetësimit .....</b>	<b>33</b>
11.1. Rëndësia e trajnimeve në fushën e ndërmjetësimit .....	33
11.2. Llojet e trajnimeve në fushën e ndërmjetësimit .....	33
11.3. Grupet e synuara në fushën e ndërmjetësimit .....	33
11.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën e ndërmjetësimit .....	33
<b>12. Trajnimet në fushat interdisiplinare .....</b>	<b>35</b>
12.1. Rëndësia e trajnimeve në fushat interdisiplinare .....	35
12.2. Llojet e trajnimeve në fushat interdisiplinare .....	35
12.3. Grupet e synuara në fushat interdisiplinare .....	35
12.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushat interdisiplinare.....	35
<b>13. Trajnimet në fushën e dhunës në familje .....</b>	<b>36</b>
13.1. Rëndësia e trajnimeve në fushën e dhunës në familje.....	36

13.2. Llojet e trajnimeve në fushën e dhunës në familje.....	36
13.3. Grupet e synuara në fushën e dhunës në familje.....	36
13.4. Plan i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën e dhunës në familje .....	36

## **Parathënie**

Nevoja për një plan veprimi për trajnime të hartuar dhe miratuar nga Këshilli, u pa e nevojshme për shkak të dinamikës së administrimit të sistemit të trajnimeve, ku mekanizmat e mbikëqyrjes dhe monitorimit të trajnimeve duhet të kishin të gjitha të dhënat e nevojshme brenda një kohë të arsyeshme, me qëllim të planifikimit brenda gjykatës dhe sistemit gjyqësor.

Plani i veprimit adreson qartë qëllimin që duhet ta ndjek gjyqtari gjatë trajnimit dhe synimet të cilat i ka sistemi gjyqësor për sa i takon avancimit të profesionalizmit e cila arrihet në masë të madhe përmes trajnimeve. Për shkak se ky është një plan tejet dinamik dhe ka ndërlidhje të fortë me sistemin e trajnimit që ofrohet nga Akademia, janë vendosur tregues të performancës të cilët duhet të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse pasi për qëllime praktike janë ndarë në fusha të veçanta të trajnimit, dhe është paraparë nga një mini-plan për secilën fushë trajnuese.

Plani i veprimit për trajnimin e gjyqtarëve adreson në mënyrë të drejtë të gjithë elementet e domosdoshme të cilat janë vlerësuar si të rëndësishme të përfshihen në këtë dokument.

Janë përcaktuar në mënyrë të kujdesshme dhe të krahasuar edhe me Akademinë e Drejtësisë të gjitha fushat e trajnimit, temat trajnuese brenda fushave të trajnimit, koha e planifikuar e mbajtjes, ditët trajnuese, numri i planifikuar i pjesëmarrësve, metodologjia e trajnimit, kategoria e gjyqtarëve që do të trajnohen, si dhe kategoritë tjera të të punësuarve të cilët mund të marrin pjesë në këto trajnime, si dhe partnerët që do ta zhvillojnë, apo do ta ndihmojnë mbajtjen e trajnimit.

Dhjetor, 2023

z. Vilard Bytyqi

Kryetar i Komisionit për Trajnime

## Shkurtesat

<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>AIP</b>	Agjencia për Informim dhe Privatësi
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
<b>IRZ</b>	Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>OPDAT</b>	Zyra e Zhvillimit, Asistencës dhe Trajnimit të Prokurorisë Jashtë shtetit (SHBA)
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>USAID</b>	U.S. Agency for International Development

## 1. Qëllimi dhe objektivat

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fushën e trajnimeve ka për obligim të bëjë politika, të vendos standarde dhe të jep rekomandime dhe propozime konkrete për Akademinë e Drejtësisë e cila sipas ligjit bazik ka për mandat ofrimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe kategoritë tjera të të punësuarëve në sistemin e drejtësisë.

Deri më tani, Këshilli përmes Komisionit për Trajnime, si mekanizëm i përhershëm dhe i specializuar, ka bërë vlerësime dhe në mënyrë periodike ka bërë propozime dhe rekomandime, e veçanërisht ka qenë pjesëmarrës aktiv në hartimin e programit trajnues të udhëhequr nga Akademia e Drejtësisë dhe partner i vazhdueshëm për ta bërë më të lehtë dhe të mundshme zhvillimin e trajnimeve ku pjesëmarrës janë gjyqtarët dhe të punësuarit e administratës së sistemit gjyqësor.

Në vitin 2023 Komisioni për Trajnime ka draftuar dy rregullore, njëra për fushën e trajnimit të gjyqtarëve dhe tjetra për fushën e trajnimeve të të punësuarve të administratës gjyqësore dhe lindi nevoja që Këshilli ta ketë një plan veprimi për trajnim, i cili duhet të jetë i koordinuar dhe harmonizuar me dokumentet vjetore të punës së Akademisë. Gjithashtu, ky plan është paraparë si aktivitet edhe nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.

Qëllimi i këtij plani të trajnimeve para së gjithash është planifikimi, organizimi dhe zbatimi i objektivave trajnuese që janë derivat i vlerësimit të nevojave për trajnime të cilat i ka sistemi gjyqësor, apo të ndërlidhura me sistemin gjyqësor. Gjithashtu, ky plan trajnimi në mënyrë të detajuar adreson çështjen e menaxhimit të procesit të trajnimeve, duke i evidentuar procedurat standarde të cilat duhet të ndiqen nga gjyqtarët si vijues dhe kryetarët e gjykatave si mbikëqyrës të drejtpërdrejt. Plani synon të ofrojë një pasqyrë më të qartë të administrimit të trajnimeve, duke rritur efikasitetin në të gjitha drejtimet, filluar nga menaxhimi më i mirë i kohës, i resurseve, reduktimi i mos-përmbushjes së përgjegjësisive brenda gjykatës, dhe ulja e mundësisë që palëve t'i dëmtohen interesat e tyre juridike në gjykata.

Ky plan, ngërthen në vete shumë elemente të rëndësishme, ku përfshihen:

- Lloji i aktivitetit trajnues: trajnim, tryezë/punëtori, seminar apo aktivitet trajnues tjetër;
- Emërtimi i aktivitetit trajnues;
- Numri i planifikuar i aktiviteteve trajnuese;
- Numri i planifikuar i vijuesve;
- Grupet e synuara të gjyqtarëve: fusha e shërbimit, shkalla e shërbimit, apo specifika tjera;
- Kohëzgjatja e aktivitetit trajnues (ditët);
- Vendi i mbajtjes së aktiviteteve trajnuese;
- Koha e mbajtjes së aktiviteteve trajnuese;
- Muaji/data e mbajtjes së aktiviteteve trajnuese;
- Të dhëna tjera me rëndësi për aktivitetet trajnuese.

Plani i veprimit përcakton rolin dhe përgjegjësitë e secilit, përkatësisht rolin e gjyqtarit si vijues i trajnimeve në njërin anë, dhe rolin e mekanizmave të sistemit gjyqësor, përfshirë kryetarin e gjykatës, Komisionin për Trajnime dhe Këshillin, në anën tjetër.

Planit të veprimit për trajnime i ka paraprirë diskutimi me Akademinë e Drejtësisë lidhur me hartimin e programit trajnues për vitin 2024, ku fillimisht Këshilli ka parashtruar propozimet e saja, pastaj ky plan-program është diskutuar në punëtori të veçanta, ndërsa në fund të nëntorit është miratuar nga Akademia e Drejtësisë. Aspektet tjera të planit janë koordinuar më pastaj me Akademinë, ku janë analizuar aspekti i kalendarit të trajnimeve për vitin trajnues 2024, si dhe planifikimi i numrit të gjyqtarëve që mund të ndjekin ato trajnime tek trajnimet e vazhdueshme.

Ky plan i trajnimeve përfshin trajnimet e vazhdueshme të gjyqtarëve, ndërsa gjyqtarët e sapo-dekretuar të cilët ndjekin trajnimin fillestar, të njëjtit ndjekin trajnimin në përputhje me programin trajnues të Akademisë dhe i nënshtrohen rregullave të Akademisë lidhur me këtë trajnim.

Plani i veprimit për trajnimin e gjyqtarëve është i ndërlidhur me vlerësimin e nevojave trajnuese që janë identifikuar gjatë vitit 2023 dhe të cilat janë reflektuar në Programin Trajnues të Akademisë për vitin 2024. Nga vlerësimi i nevojave është vlerësuar se janë disa fusha prioritare të cilat duhet të kenë vëmendje të duhur për zhvillimin e trajnimeve dhe aktiviteteve trajnuese që gjyqtarët duhet t'i avancojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat profesionale, në fushat sikurse në vijim:

- Trajnime nga fusha penale;
- Trajnime nga fusha civile;
- Trajnime nga fusha komerciale;
- Trajnime nga fusha administrative;
- Trajnime në fushën e praktikës së gjykatës kushtetuese;
- Trajnime nga fusha të drejtave të njeriut;
- Trajnime në fushën e të drejtës evropiane;
- Trajnime në fushën e kundërvajtjeve;
- Trajnime në fushën e ndërmjetësimit trajnimet në fushat interdisiplinare;
- Trajnime në fushën e dhunës në familje.

Plani i veprimit do të përqendrohet në arritjen e objektivave trajnuese përmes trajnimeve të cilat janë hartuar për programin trajnues për vitin 2024 dhe do të përqendrohen në dy forma të trajnimit, përkatësisht në trajnimet klasike dhe në tryezat profesionale.



## **2. Administrimi i sistemit të trajnimeve: Aplikimi, aprovimi, monitorimi, mbikëqyrja dhe raportimi**

Çështja e administrimit të trajnimit nga sistemi gjyqësor ndërlidhet me tri faza kryesore. Faza e parë, është vlerësimi i rëndësisë së trajnimit nga vet gjyqtari. Faza e dytë, është vlerësimi i rëndësisë së trajnimit lidhur me fushën profesionale nga kryetari i gjykatës ku shërben gjyqtari. Faza e tretë, përfshin raportimin e kryetarit të gjykatës tek Komisioni për Trajnime, ku ky mekanizëm e ka obligim t'i analizojë dhe përpunojë informacionet e pranuar nga kryetarët e gjykatave, dhe në përfundimisht duhet të jep vlerësimet e tij, përfshirë rekomandimet konkrete nëse janë të nevojshme.

### **2.1. Faza e parë**


Gjyqtari ka të drejtë të merr pjesë në trajnimet e vazhdueshme në fushat trajnuese ku është e nevojshme për zhvillimin dhe ngritjen profesionale të tij. Gjyqtari çdo herë duhet t'i përzgjedh temat trajnuese që janë relevante për punën e tij, duke përjashtuar trajnimet e panevojshme, të parëndësishme dhe trajnimet e përsëritura për fushat e njëjta profesionale.

Gjyqtari i cili ka interesim për të marrë pjesë në trajnimet në vitin trajnues për vitin 2024, duhet të aplikojë në fushën dhe temat trajnuese të përfshira në programin trajnues të Akademisë së Drejtësisë.

Gjyqtari fillimisht duhet të paraqes kërkesën e tij përmes sistemit elektronik të Akademisë, apo përmes formës fizike. Gjyqtari saktësisht duhet të përfshirë fushën dhe temën trajnuese.

Gjyqtari duhet t'i jep përparësi punës së tij si gjyqtarë dhe asnjëherë nuk mundet t'i rrezikojë aktivitetet e ligjshme të gjykatës apo zyrës së gjyqtarit me pjesëmarrjen e tij në trajnime.

Cikli i aplikimit prezantohet përmes figurës sikurse në vijim:



## 2.2. Faza e dytë

Kryetari i gjykatës, pas kërkesës së gjyqtarit për aplikim për trajnim, duhet të ketë parasysh nëse trajnimi i tillë i shërben drejtpërdrejt gjyqtarit në punën e tij, si dhe nëse mungesa e gjyqtarit për një kohë të caktuar mund të shkaktoj pengesa në punën e gjykatës përkatëse dhe në punën e gjyqtarit. Kryetari i gjykatës shqyrton dhe aprovon/refuzon kërkesat për trajnim nga gjyqtarët. Për trajnimin të cilin ka aplikuar dhe i është aprovuar nga kryetari i gjykatës, gjyqtari është i obliguar ta ndjekë, përveç nëse paraprakisht prezanton arsye të bazuara se nuk mund ta vijojë trajnimin e tillë.

Cikli i kësaj faze prezantohet përmes figurës sikurse në vijim:



### 2.3. Faza e tretë

Kryetari i gjykatës përkatëse për çdo 6 muaj informon me raport me shkrim Komisionin për Trajnime për pjesëmarrjen e gjyqtarëve në trajnime apo aktivitete tjera trajnuese. Raporti duhet të përmbajë përshkrim të informacioneve lidhur me llojin e trajnimit të ndjekur nga secili gjyqtar, kohëzgjatjen e trajnimit, informatat nëse për rastet kur gjyqtarëve iu është refuzuar pjesëmarrja në trajnime të ndryshme, përfshirë arsyetimin për një refuzim të tillë dhe mos-ndjekja e trajnimeve të aprovuara.

Komisioni për Trajnime mund të kërkoj informacione shtesë apo sqarime tjera lidhur me raportet e pranuar nga kryetarët e gjykatave.

Cikli i kësaj faze prezantohet përmes figurës sikurse në vijim:



### 3. Trajnimet nga fusha penale

#### 3.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha penale

Trajnimet nga fusha penale i dedikohen gjyqtarëve të cilët janë të caktuar për të gjykuar lëndë nga fusha penale në të gjitha shkallët gjyqësore. Këto trajnime janë harmonizuar me trajnimet të cilat ndjekin në trajnimet bazike, përkatësisht në trajnimin fillestar të gjyqtarëve, me qëllim që temat trajnuese të mos përsëriten dhe këto trajnime të jenë të rëndësishme dhe të mos jenë të përsëritura. Disa nga trajnimet do të ofrohen përmes trajnimeve tradicionale, ndërsa disa të tjera do të zhvillohen përmes tryezave profesionale, ku referohen nga gjyqtarë nga shkallët më të larta gjyqësore të cilët bazuar në gjetjet që janë nxjerrë nga vlerësimi i vendimeve të shkallëve më të ulëta, përkatësisht nga niveli i gjykatës së apelit apo nga niveli i gjykatave themelore.

Qëllimi i trajnimeve nga fusha penale konsistojnë në avancimin e njohurive, kompetencave dhe shkathtësive të veçanta profesionale, të cilat do të kontribuojnë në efikasitetin e veçantë të gjyqtarit dhe efikasitetin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor.

#### 3.2. Llojet e trajnimeve nga fusha penale

Në këtë grup trajnimesh pjesëmarrësit do kenë mundësinë të trajnohen në:

- Pastrimi i parave dhe hetimi financiar;
- Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë;
- Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare;
- Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm;
- Krimet e luftës;
- Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit;
- Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështrim i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore;
- Krimi kibernetikë dhe kriptovalutat;
- Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues;
- Gjykimi në mungesë;
- Përpilimi i aktakuzës, arsyetimi dhe vlerësimi i provave;
- Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore;
- Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore;
- Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi
- Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve;
- Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktimat të dhunës seksuale;

- Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit dhe Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit.

### 3.3. Grupet e synuara nga fusha penale

- Gjyqtarët e departamentit të përgjithshëm – divizioni penale;
- Gjyqtarët e departamentit të krimeve të rënda;
- Gjyqtarët e Departamentit Special – GJTH Prishtinë;
- Gjyqtarët e Departamentit Special – Gjykata e Apelit;
- Gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

### 3.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën penale

Nr.	Emërtimi i temës	Data e planifikuar e realizimit	Kohëzgjatja	Përfituesit	Nr. i planifikuar i pjesëmarrjes	Metodologjia e realizimit të trajnimit	Në Bashkëpunim
1.	Pastrimi i parave dhe hetimi financiar	05-06 Mars 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	IRZ OPDAT
2.	Pastrimi i parave dhe hetimi financiar	3-4 Shtator 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	IRZ OPDAT
3.	Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë	27-28 Mars 2024	2 ditë	Gjyqtarët, Bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	OPDAT
4.	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	14-15 Maj 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	ËBROLI
5.	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	19-20 Shtator 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	OPDAT
6.	Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm	24-25 Prill 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët e agjencive ligj-zbatuese	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
7.	Krimet e luftës	19-20 Mars 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtorët profesional dhe policia	20-25	Tryezë e diskutimit	AD&Fondi për të Drejtën Humanitare

8.	Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit	11 Qershor 2024	2 ditë	Gjyqtarët, prokurorë si dhe mundësisht edhe udhëheqësit e këtyre institucioneve.	20-25	Tryezë e diskutimit	AD OPDAT
9.	Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit	10 Shtator 2024	2 ditë	Gjyqtarët, prokurorë si dhe mundësisht edhe udhëheqësit e këtyre institucioneve.	20-25	Tryezë e diskutimit	AD OPDAT
10.	Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështrim i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore	12-13 Shtator 2024	2 ditë	Gjyqtarët penalistë.	20-25	Tryezë e diskutimit	UNODC
11.	Krimi kibernetikë dhe kriptovalutat	04-05 Qershor 2024	2 ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Hetuesit, Zyrtar të NJIF-it, Ekspertët e PSRK, Bashkëpunëtorët profesional	20-25	Trajnim	AD OPDAT
12.	Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues	01 Shkurt 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtorët profesional	20-25	Trajnim	AD OPDAT
13.	Gjykimi në mungesë	08 Shkurt 2024	1 ditë	Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtor profesional.	20-25	Trajnim	AD OPDAT
14.	Përpilimi i aktakuzës, arsyetimi dhe vlerësimi i provave	16 Tetor 2024	1 ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët ligjor.	20-25	Trajnim	AD OPDAT
15.	Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore	03 dhjetor 2024	1 ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Mbrojtësit e viktimave.	20-25	Trajnim	AD
16.	Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore	07 Nëntor 2024	1 ditë	Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor profesional dhe Hetues policor.	20-25	Trajnim	AD OPDAT
17.	Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi	27 Shkurt 2024	1 ditë	Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor profesional dhe Hetues policor.	20-25	Trajnim	AD& QKRMT
18.	Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve	12-16 Shkurt 2024	5 ditë	Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit në departamentin special, departamentin e krimeve të rënda dhe departamentin e përgjithshëm.	20-25	Trajnim	UNDP/SA EK
19.	Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve	15-19 Prill 2024	5 ditë	Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit në departamentin special, departamentin e krimeve të rënda dhe departamentin e përgjithshëm.	20-25	Trajnim	UNDP/SA EK
20.	Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve –	01 tetor 2024	1 ditë	Gjyqtarë dhe Prokurorë nga Departamenti për të Mitur, Mbrojtësit e viktimave Bashkëpunëtor profesional, Zyrtarë Policor, Qendra për Pune Sociale.	20-25	Trajnim	AD& QKRMT

	viktima të dhunës seksuale						
21.	Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit dhe Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit	14 mars 2024	1 ditë	Gjyqtarë për të mitur, prokurorë për të mitur, zyrtarë nga Shërbimi Sprovues	20-25	Trajnim	AD



## 4. Trajnimet nga fusha civile

### 4.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha civile

Trajnimet nga fusha civile i dedikohen gjyqtarëve të cilët janë të caktuar për të gjykuar lëndë nga fusha civile në të gjitha shkallët gjyqësore. Këto trajnime janë harmonizuar me trajnimet të cilat ndjekin në trajnimet bazike, përkatësisht në trajnimin fillestar të gjyqtarëve, me qëllim që temat trajnuese të mos përsëriten dhe këto trajnime të jenë të rëndësishme dhe të mos jenë të përsëritura. Disa nga trajnimet do të ofrohen përmes trajnimeve tradicionale, ndërsa disa të tjera do të zhvillohen përmes tryezave profesionale, ku referohen nga gjyqtarë nga shkallët më të larta gjyqësore të cilët bazuar në gjetjet që janë nxjerrë nga vlerësimi i vendimeve të shkallëve më të ulëta, përkatësisht nga niveli i gjykatës së apelit apo nga niveli i gjykatave themelore.

Qëllimi i trajnimeve nga fusha civile konsistojnë në avancimin e njohurive, kompetencave dhe shkathtësive të veçanta profesionale, të cilat do të kontribuojnë në efikasitetin e veçantë të gjyqtarit dhe efikasitetin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor.

### 4.2. Llojet e trajnimeve nga fusha civile

Në këtë grup trajnimesh pjesëmarrësit do kenë mundësinë të trajnohen në:

- Anulimi i Kontratave;
- Fitimi i pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dha baza e ndërtimit;
- Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta);
- Procedura Jokontestimore;
- Procedura Përmbartimore;
- Procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë;
- Shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes – Afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural;
- Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile;
- Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile;

### 4.3. Grupet e synuara nga fusha civile

- Gjyqtarët e gjykatave themelore nga fusha civile;
- Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit nga fusha civile;
- Gjyqtarët e Gjykatës Supreme nga fusha civile;

### 4.4. Plani i veprimit për trajnimet e planifikuara për vitin 2024 në fushën civile

Nr.	Emërtimi i temës	Data e planifikuar e realizimit	Kohëzgjatja	Përfituesit	Nr. i planifikuar i pjesëmarrjes	Metodologjia e realizimit të trajnimit	Në Bashkëpunim
1.	Anulimi i Kontratave	06-07 Shkurt 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
2.	Fitimi i pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit	12-13 Mars 2024	2 ditë	Gjyqtarët e gjykatës së Apelit, Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
3.	Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta)	28-29 Shkurt 2024	1 tryezë, 2 ditë	Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
4.	Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta)	17-18 Shtator 2024	1 tryezë, 2 ditë	Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
5.	Procedura Jokontestimore	07-08 Maj 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Themelores dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
6.	Procedura Përmbartimore	12-13 Qershor 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional/eventualisht përmbartuesit privat	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
7.	Procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë	25-26 Qershor 2024	2 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
8.	Shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes – Afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural	24 Shtator 2024	1 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore	20-25	Tryezë e diskutimit	AD
9.	Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	29 tetor 2024	1 ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	20-25	Trajnim	AD

10.	Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	23-24 prill 2024	2 ditë	Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil; gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil.	20-25	Trajnim	GIZ
-----	---	------------------	--------	---	-------	---------	-----

## 5. Trajnimet nga fusha komerciale

### 5.1. Rëndësia e trajnimeve nga fusha komerciale

Trajnimet nga fusha komerciale i dedikohen gjyqtarëve të cilët janë të caktuar për të gjykuar lëndë nga fusha komerciale në dhomat e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale. Këto trajnime janë harmonizuar me trajnimet të cilat ndjekin në trajnimet bazike, përkatësisht në trajnimin fillestar të gjyqtarëve, me qëllim që temat trajnuese të mos përsëriten dhe këto trajnime të jenë të rëndësishme dhe të mos jenë të përsëritura. Disa nga trajnimet do të ofrohen përmes trajnimeve tradicionale, ndërsa disa të tjera do të zhvillohen përmes tryezave profesionale, ku referohen nga gjyqtarë nga shkallët më të larta gjyqësore të cilët bazuar në gjetjet që janë nxjerrë nga vlerësimi i vendimeve të shkallëve më të ulëta.

Qëllimi i trajnimeve nga fusha komerciale konsistojnë në avancimin e njohurive, kompetencave dhe shkathtësive të veçanta profesionale, të cilat do të kontribuojnë në efikasitetin e veçantë të gjyqtarit dhe efikasitetin e përgjithshëm të Gjykatës Komerciale.

### 5.2. Llojet e trajnimeve nga fusha komerciale

Në këtë grup trajnimesh pjesëmarrësit do kenë mundësinë të trajnohen në:

- Marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet komerciale;
- Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Hulumtimi, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në fushën komerciale;
